



Financuar nga
Bashkimi Evropian

UDHËZUES PËR KUJDESHIN NDAJ KAFSHËVE NË FERMË



KAFSHË TË SHËNDETSHME, FITIM I GARANTUAR:
Biosiguria është investimi më i mirë
për fermën tuaj!

Praktikat strikte të biosigurisë dhe higjienës parandalojnë sëmundjet, ulin kostot, rrisin mirëqenien e kafshëve dhe përmirësojnë cilësinë e qumështit.

PRAKTIKAT KRYESORE TË BIOSIGURISË



Kontrolloni lëvizjen e kafshëve: Vendosni kafshët e reja në karantinë për së paku 2 javë përpara se t'i vendosni në tufë.



Kontrolloni për sëmundje: Monitoroni kafshët për shenja të hershme të sëmundjes, të tilla si kollitja ose humbja e peshës.



Izoloni kafshët e sëmura: Mbani kafshët e sëmura të izoluar për të parandaluar përhapjen e sëmundjes.



Kontrolloni lëvizjen e njerzëve: Vendosni dezbariera, mbani shënime dhe kufizoni lëvizjen e njerzëve dhe mjeteve.

PRAKTIKAT MË TË MIRA TË HIGJENËS NË FERMË



Pajisjet e mjeljes: Lani makinat, gypat dhe rezervuarët pas çdo përdorimi për të parandaluar ndotjen bakteriale.



Gjinjtë e kafshëve: Pastroni gjinjtë me ujë të pastër ose dezinfektues përpara se të fillojë mjelja.



Higjiena e personelit: Punëtorët duhet të lajnë duart para mjeljes, të veshin rroba të pastra dhe të dezinfektojnë çizmet.



Pastërtia e shtallës: Pastroni rregullisht dyshemetë, muret dhe hapësirat tjera për të zvogëluar rrezikun nga sëmundjet.

PROTOKOLLET E DEZINFEKTIMIT



Dezinfektoni pajisjet e mjeljes dhe të ushqimit me dezinfektues të përshtatshëm.



Sigurohuni që kafshët të kenë qasje në ujë të pastër.



Dezinfektoni rregullisht të gjitha sipërfaqet ku jetojnë dhe ushqehen kafshët.



Financuar nga
Bashkimi Evropian

SËMUNDJET MË TË SHPESHTA TË KAFSHËVE NË FERMA DHE PARANDALIMI I TYRE

Parandalimi dhe diagnostifikimi i hershëm i sëmundjeve zvogëlon humbjet në fermë!

TUBERKULOZI (TBC)

SHENJAT:

Humbje peshe, kollitje,
ënjtje të nyjeve limfatike,
ulje të prodhimit të
qumështit.

PARANDALIMI:

Njoftimi i hershëm,
testimi dhe izolimi i
rregullt i kafshëve të
infektuara.

BRUCELOZA

SHENJAT:

Aborte, infertilitet,
sekrecione jonormale,
reduktim i prodhimit të
qumështit.

PARANDALIMI:

Njoftimi i hershëm,
testimi dhe izolimi i
kafshëve të reja.

MASTITI

SHENJAT:

Gjinjtë e enjtur,
qumështi jokualitativ,
prodhimi i zvogëluar i
qumështit.

PARANDALIMI:

Mbani shtallat dhe
pajisjet e mjeljes të
pastra.



BLINI KAFSHË TË SHËNDETSHME NGA FERMA TË BESUESHME



Për të siguruar qëndrueshmërinë e fermës blini gjithmonë bagëti nga burime të besueshme. Kafshët pa status shëndetësor mund të bartin sëmundje duke rrezikuar gjithë tufën dhe fermat aty pranë. Para se të blini, kontrolloni certifikatat shëndetësore, verifikoni të dhënat e vaksinimit dhe izoloni kafshët e reja për të paktën 2 javë.

SHËNDETI I KAFSHËVE

Një tufë e shëndetshme rrit cilësinë e qumështit, ul kostot veterinare dhe rrit përfitimet. Parandalimi i sëmundjeve kushton më pak se trajtimi i tyre.

NDIKIMI I SHËNDETIT TË KAFSHËVE NË FERMËN TUAJ

Cilësi më e lartë e qumështit dhe mishit: Kafshët e shëndetshme prodhojnë më shumë dhe me cilësi më të lartë.

Shpenzime më të ulëta: Parandalimi i sëmundjeve redukton shpenzimet.

Reputacion më i mirë: Ferma etike tërheq klientët besnikë.

RRITJA E FITIMEVE PËRMES BIOSIGURISË

Hapat kryesorë për shëndetin e tufës dhe përfitimet e fermës



Mbani pastër
objektet dhe
pajisjet.



Kontrolle të
rregullta
shëndetësore
veterinare.



Monitoroni
kafshët për
shenjat e
hershme të
sëmundjeve.



Trajnimi i
punëtorëve për
mbajtjen e
higjienës.